

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 29.10.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Maja Damevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Argjend Xhelili, Viktor Stojanov, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë:/**

Z. Petrushevski hapi seancën e 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, Salla e Konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 24.10.2024.
2. Shqyrtimi i raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2024.
3. Propozim për dhënien e miratimit të drejtorit të Agjencisë për nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me Propozim – Marrëveshje Kolektive.
4. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 40-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 24.10.2024, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 korrik deri më 30 shtator 2024.

## **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit drejtorit të Agjencisë për nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me Propozim-Marrëveshje Kolektive. Ai shpjegoi se në periudhën e fundit ka gjithnjë e më shumë institucione shtetërore që nënshkruajnë Marrëveshje Kolektive me sindikatat e degëve, e cila rregullon marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet që kanë të punësuarit. Ai tha se Agjencia ka Organizatë sindikale që është pjesë e Sindikatës së të punësuarve nga administrata, organet gjyqësore, shoqatat e qytetarëve, e njohur si AGJOSH. Disa muaj më parë, anëtarët e Sindikatës së bashku me kryetarin e AGJOSH, kanë punuar në tekstin e marrëveshjes kolektive, e cila është dorëzuar në seancë si propozim. Qëllimi i marrëveshjes është rregullimi i të drejtave, detyrimeve, përgjegjësive dhe çështjeve të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të të punësuarve, por që janë të drejta më të mëdha dhe më të favorshme se ato të parashikuara në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, Marrëveshjen kolektive të degës dhe Marrëveshjen kolektive të përgjithshme për sektorin publik. Me këtë Marrëveshje Kolektive, futen të drejta dhe risi më të favorshme për të punësuarit në Shërbimin Profesional të Agjencisë, si p.sh do të mundësohet puna në distancë një ditë gjatë javës, për të cilën do të mbahet (vendoset) dhe evidencë përkatëse e orarit të punës, më pas nëse anëtar i familjes ka formë të rëndë të sëmundjes, atëherë puna në distancë mund të jetë më e gjatë, ndërsa puna në distancë mund të organizohet dhe më gjatë për kushte të pafavorshme të motit, temperatura jashtëzakonisht të ulëta ose të larta ose në rast të kushteve emergjente, siç ishte pandemia në 2020-2021. Pushimi vjetor rritet deri në maksimum 32 ditë me kriteret të përcaktuara saktësisht në bazë të të cilave përcaktohet pushimi vjetor - koha e kaluar në marrëdhënie pune, ngarkesa në vendin e punës që deri më tani ka qenë 1 ditë, dhe tani propozohet nga 1 deri në 3 ditë në varësi të pozicionit të punës, moshës, gjendjes shëndetësore, gjegjësisht të drejtën në edhe 2 ditë pune plotësuese nga pushimi vjetor kanë të punësuarit që janë të sëmurë ose vuajnë nga çrregullime më të rënda shëndetësore, e cila do të vërtetohen me rekomandim nga mjeku, gjegjësisht vërtetim mjekësor. Për sa i përket pushimit me pagesë, vendoset mundësia për 4 orë pushim privat me pagesë gjatë një muaji, i cili nuk duhet të punohet dhe nuk kompensohet me pushim vjetor. Gjithashtu, plotësuese mund të shfrytëzohen dhe 4 orë pune për nevoja private, të cilat duhet ose të punohen ose të zëvendësohen me ditë nga pushimi vjetor. Deri më tani, pas kthimit nga udhëtimi zyrtar, të punësuarit të nesërmen duhet të paraqiteshin në punë, pavarësisht se kur ishte kthyer nga udhëtimi zyrtar. Me Marrëveshjen Kolektive, mundësohet që nëse kthimi është në periudhën nga ora 20:00 deri në mesnatë, të mund ditën e nesërme të punon në distancë, gjë që duhet të sigurojë 12 orë pushim të pandërprerë. Nëse kthimi është pas mesnatës, i punësuarit atë ditë ka të drejtë të pushimit me pagesë, ose nëse udhëtimi zyrtar ose kthimi është në ditë

jopune ose festë, ai ka të drejtë në pushim proporcional të paguar në ditën e parë të punës pas kthimit. Marrëveshja kolektive parasheh mundësinë e sigurimit shëndetësor privat, me atë që gjysmën e shumës e paguan punëdhënësi dhe gjysmën tjetër punëmarrësi, si dhe detyrimin për kontrolle të rregullta mjekësore çdo 12 muaj në vend të 18 muajve, që parashihet me Ligjin për marrëdhënie pune. Ndryshohet edhe mënyra e llogaritjes së pagës, përkatësisht paga bazë bruto do të përpilohet nga paga mesatare bruto, koeficientit të vështirësisë të vendit të punës dhe pjesë e pagës për stazhin (vitet e punës). Kjo mënyrë e llogaritjes hyn në fuqi me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Kolektive, por duhet bërë ndryshim, në mënyrë që dispozitat që kanë të bëjnë me pagën të zbatohen nga 1 dhjetori 2024. Arsyeja është se mënyra e re e llogaritjes së pagave nuk mund të zbatohet me pagesën e pagës për muajin nëntor, sepse fillimisht duhet të bëhet ndryshim në Rregulloren për pagesën e pagave dhe kjo do të ndodhë pas miratimit të Marrëveshjeje kolektive nga Këshilli dhe nënshkrim me kryetarin e AGJOSH-së. Baza për llogaritjen e koeficientit të vështirësisë në vendin e punës është paga bruto mesatare e paguar në vitin 2023, e rritur për 5%, në pajtim me marrëveshjen kolektive për sektorin publik. Përveç kësaj, koeficienti i vështirësisë të vendit të punës rritet sipas shkallës së arsimimit. Përqindjet e sakta gjenden në tekstin e Marrëveshjes Kolektive dhe janë ekuivalente me 100, 50 ose 20 pikë sipas mënyrës aktuale të llogaritjes së pagës sipas Rregullores për pagën bruto. Përcaktohet dhe e drejta e shtesës së pagës, në masë nga 30% të shumës së pagës bazë, për shkak të specifikave dhe kompleksitetit të punës ose vëllimit të shtuar të detyrave të punës, me kritere të përcaktuara saktë për përcaktimin e kësaj shtesë. Gjithashtu, rriten dhe shpenzimet lidhur me punën e kompensimit për ndihmë financiare në rast të vdekjes së punonjësit ose anëtari të familjes së ngushtë, së paku dy paga mesatare neto dhe shpërblim (çmim) jubilar, që deri më tani ka qenë një pagë mesatare, tani për 30 apo 40 vite stazh dhe daljes në pension propozohen dy paga mesatare neto.

Z. Petrushevski falënderoi për prezantimin dhe tha se me të vërtetë ka shumë përfitime për të punësuarit. Ai e përshëndeti Marrëveshjen e propozuar Kolektive dhe tha se të punësuarit në Agjencion sipas tij i meritojnë këto propozime. Ai deklaroi se do të japë mbështetje.

Z. Trajçev tha se pajtohet me faktin se të punësuarit në Agjenci meritojnë shumë më tepër se sa propozohet, sepse Agjencia është një nga institucionet në vend që mund të thuhet se ka një vëllim të madh të punës dhe nivelin më të lartë të profesionalizmit. Ai shpjegoi se është përkrahës i Marrëveshjeje kolektive, sepse ato promovojnë disa të drejta dhe në shoqëritë demokratike u mundësojnë të punësuarve të kenë jetë cilësore. Ai shpjegoi se nga ana tjetër, ata si Këshill nuk kanë rol në përgatitjen e vetë tekstit, në negociimin e këtyre dispozitave. Përveç dispozitave të shumta dhe të mira që i tregoi drejtori, nga ana e tij ka edhe dispozita të paqarta, të cilat deri në fund nuk janë të definuara. Ai njoftoi se do t'i përmbahet një dispozite që nuk është e qartë për të, siç është neni 7 paragrafi (1) që të punësuarit kanë të drejtë të punojnë në distancë një ditë gjatë javës, në pajtim me orarin e bërë nga udhëheqësi ndërmjetësues, i cili mban llogari për shtrirjen dhe dinamikën e detyrave të punës. Nëse kështu lexohet, do të thotë që çdo i punësuar detyrimisht duhet në javë një ditë të jetë në shtëpi dhe të punojë nga shtëpia, gjë që nuk është e përshtatshme sepse natyra e punëve këtë nuk e lejon për të gjitha vendet e punës. Sipas tij, kjo është formuluar në atë mënyrë që të krijohen paqartësi dhe ndoshta nuk është menduar për këtë. Ka edhe dispozita të tjera të cilat sipas tij, nga pikëpamja juridike janë të paqarta, të papërcaktuara dhe mund të shkaktojnë mundësi për interpretime të ndryshme. Në anën tjetër, si anëtar i Këshillit, mandati i të cilit përfundon shumë shpejt sepse tashmë në Kuvendin e RMV-së është shpallur njoftim për zgjedhjen e anëtarëve të rinj, në fund të mandatit të sjellin një akt të tillë, para ardhjes së

anëtarëve të rinj, për të është joparimore dhe nuk mund të pajtohet. Me gjithë respektin ndaj të gjithë të punësuarve dhe ndaj qëllimit të mirë të drejtorit kjo të zbatohet, por nëse dhe Këshilli do ishte i përfshirë në diskutime, në negociata, ku formulime të tilla do të ishin të qarta, në këtë rast ato mund të jenë vetëm konfuzion dhe lëndë për konflikte të ardhshme dhe mosmarrëveshje dhe paqartësitë në zbatim. Ai deklaroi se këtë Marrëveshje Kolektive nuk mund ta mbështeste.

Z. Fidanoski tha se do të mbështesë propozimin për Marrëveshjen Kolektive. Ai pajtohet me konstatimin e kryetarit Petrushevski se janë propozuar përfitime më të mëdha për të punësuarit, gjë që sipas tij është mirë, sepse në këtë mënyrë do të nxitet për punë edhe më cilësore në të ardhmen dhe njëkohësisht do të jetë nxitje për realizimin e qëllimeve të vendosura që i kanë në punën e tyre. Ai beson se do të jetë kështu dhe se të punësuarit do të arsyetojnë në atë mënyrë atë që përmban marrëveshja. Ai theksoi se është përkrahës i nënshkrimit të marrëveshjeve kolektive, siç tha edhe z. Trajçev. Në këtë mënyrë, të punësuarit do të kenë siguri, stabilitet dhe mundësi më të mëdha për t'u përkushtuar ndaj obligimeve të tyre të punës. Ai tha se nuk pajtohet me deklaratën e z. Trajçev se nuk duhet të marrin vendime sepse kjo përbërje e Këshillit është në fund të mandatit dhe për shkak se Kuvendi ka shpallur konkurs që është në vazhdim. Ai shpjegoi se pavarësisht se sa zgjat mandati, sipas tij, deri në ditën e fundit, kanë detyrim dhe të drejtë ligjore që të marrin vendime për të cilat janë kompetentë. Në këtë rast, duhet t'i japin miratim drejtorit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje kolektive me Organizatën sindikale të Agjencisë, por edhe me AGJOSH, Sindikatën e degës që është në kuadër të Lidhjes së Sindikatës së Maqedonisë. Për këto arsye mendon se Këshilli duhet ta mbështesë këtë dokument, për të cilin personalisht do të votojë "pro".

Z. Trajçevski sqaroi se bisedimet me Organizatën sindikale të Agjencisë, me të cilën konsideron se kanë marrëdhënie partneriteti, kanë zgjatur më shumë se një vit. Gjatë periudhës zgjedhore, nuk ishte ligjërish e lejuar miratimi i akteve të tilla. Bisedimet vazhduan më pas pas qershorit të vitit 2024, kur u formua Qeveria dhe kjo marrëveshje u finalizua në formën që është sot temë diskutimi. Ai është në pajtim se në Kuvend është shpallur konkursi për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit, por në seancën e kaluar Këshilli i Agjencisë solli ndryshime të rëndësishme në rregullore. Ai shpjegoi se nuk është e mundur të ulesh dhe të mos sillen asnjë akt sepse ka konkurs. Konkurs ka pasur dhe në vitin 2019 dhe 2021 dhe kjo nuk do të thotë që Këshilli duhet të presë të përfundojë konkursi dhe gjithë atë periudhë të mos punojë. Deshi apo s'deshi Këshilli do të duhet muajin e ardhshëm shumë shpejt të miratojë Planin Financiar dhe Programin e Punës, pavarësisht nëse do të realizohet konkursi. Ai tha se konkursi i Kuvendit absolutisht nuk është arsye për mospërkrahjen e Marrëveshjes Kolektive. Ai tha se tani në këtë periudhë është arritur pajtim për të gjitha pikat e marrëveshjes dhe për këtë është dhënë si propozim në seancë dhe nuk ka asnjë arsye tjetër.

Z. Ajdini tha se e kishte shqyrtuar me kujdes tekstin e Marrëveshjes Kolektive të propozuar. Ai deklaroi se gjithmonë ka qenë dhe do të jetë mbrojtës (luftëtar) për më shumë të drejta dhe përfitime për të punësuarit, kështu që për këtë dokument i cili mendon se përmban të gjitha këto, do të japë mbështetje.

Z. Jançeski tha se detajisht e ka lexuar Marrëveshjen Kolektive dhe mendon, sikurse edhe bashkëbiseduesit e mëparshëm, se të punësuarit meritojnë kushte shumë më të favorshme se ato aktuale, para së gjithash për shkak të kompleksitetit të punës dhe për shkak të të gjitha aktiviteteve që kanë pasur vitet e fundit. Por sipas tij, ka disa pika për të cilat mendon se nuk janë në përputhje me normat ligjore pozitive në vend. Z. Trajçev përmendi

nenin 7 me punën online, me të cilin çdo i punësuar sipas kësaj Marrëveshjeje Kolektive ka të drejtë një herë në javë të punojë në distancë, ka të drejtë që dhe nuk mund ta shfrytëzojë. Ai tha se është i njohur me rastin e shumë kompanive, kryesisht private, që ushtrojnë punë online, por kryesisht janë kompani informative. Dihet se Agjencia ka sistem menaxhimi të dokumenteve, dhe se shumë punë mund të bëhen online, por një vendim i tillë mund të çojë në diskriminim të caktuar të disa kategorive të të punësuarve. Jo të gjithë mund ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, ka shërbime si arkiva, roje, shoferë, higjienistë nga ku do të shkelet parimi kushtetues i barazisë mes të punësuarve, gjegjësisht qytetarët do të distancohen. Ai deklaroi se janë disa punë që e çojnë që mos të votohet për këtë Marrëveshje Kolektive. Ai ka shpjeguar se sipas tij, do të ishte më mirë nëse situata të ishte më transparente në raport me anëtarët e Këshillit, të organizohej ndonjë prezantim, të diskutohej për këto punë dhe ndoshta kjo do të çonte në formulime më të mira. Ai tha se ka edhe gjëra të mrekullueshme, pajtohet me pjesën më të madhe të punëve që përmban kjo marrëveshje kolektive, por në këtë moment tha se nuk është i sigurt dhe mendon se çfarë nëse nesër, pasnesër dikush e sfidon këtë Marrëveshje Kolektive në lidhje me normat juridike pozitive, ai nuk dëshiron të marrë përgjegjësi për votimin e diçkaje që mbase nesër mund të kontestohet. Ai informoi se ndërkohë është konsultuar me disa avokatë dhe për këtë arsye nuk mund ta mbështesë këtë Marrëveshje.

Nënkryetari i Organizatës Sindikale të Agjencisë Viktor Stojanov sqaroi se neni 7, të cilin e kanë vënë në dukje disa nga anëtarët e Këshillit, është inspirim nga nevoja për të pasur punë fleksibile, por në rastet kur puna mund të kryhet nga shtëpia ose nga distanca. Më saktë. Të punësuarit që propozuan këtë nen janë inspiruar nga vizita e rregullatorit në (Rajnen veriore) Severna Rajna-Vestfalija në Gjermani, ku të punësuarit kanë mundësinë të punojnë nga dy ditë në shtëpi. Dhe ata kanë të punësuar që punojnë në arkiv, kanë shoferë, dhe atje puna është organizuar kështu që nuk do të punohet në distancë nëse ka nevojë urgjente për të punuar nga zyra, siç shkruhet dhe në vetë nenin, udhëheqësi ndërmjetësues e organizon punën. Ai tha se edhe në Marrëveshjen kolektive të propozuar do të ishte kështu, për shembull organizimi i Ditëve të Arsimimit Mediatik, kur ka zgjedhje, kur ka punë që nuk mund të realizohen në distancë, atëherë udhëheqësi ndërmjetësues do ta organizojë punën dhe do të punohet nga zyra. Ai gjithashtu shpjegoi se kjo Marrëveshje Kolektive ka qenë në përgatitje që nga fillimi i shtatorit 2023 dhe një version i marrëveshjes ka ekzistuar para shpalljes së zgjedhjeve rreth shkurtit-marsit 2024. Pas përfundimit të zgjedhjeve, meqenëse nuk mund në periudhën zgjedhore të nënshkruhen marrëveshje kolektive, pas diskutimeve me drejtorin si punëdhënës, Sindikata e Agjencisë bëri ndryshime të propozim tekstit. Për disa punë u pajtuan, me të cilat do të rrisin të drejtat e të punësuarve dhe do të jenë më të mira se Marrëveshja Kolektive e Degës dhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive në sektorin publik. Kështu erdhëm deri te ky tekst përfundimtar, i cili u propozua në seancë e Sindikatit të Agjencisë, e cila tani numëron më shumë se 40 të punësuar.

Kryetari i Organizatës Sindikale të Agjencisë, mr. Argjend Xhelili, kërkoi në emër të të gjithë të punësuarve, Këshilli të mbështesë propozimin e Marrëveshjes Kolektive. Ai shpjegoi se dokumenti është përgatitur për më shumë se një vit dhe gjatë kësaj periudhe janë anëtarësuar edhe 20 të punësuar si anëtarë të ri në Organizatën Sindikale, që do të thotë se është rreth 80 për qind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Për përgatitjen e tekstit të Marrëveshjes Kolektive të propozuar u konsultuan me AGJOSH dhe institucione të tjera relevante, dhe kërkoi edhe një herë që Marrëveshja të marrë mbështetjen e Këshillit.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahje të punës së drejtorit dhe të Këshillit, shefe e kabinetit mr. Dragica Ljubevska shpjegoi Propozimin e Marrëveshjes Kolektive e ka shqyrtuar disa herë, por jo si anëtare e Organizatës Sindikale të Agjencisë, sepse nuk është, por nga aspekti i përputhshmërisë me dispozitat ligjore pozitive. Ajo nga kolegët e Sektorit juridik, ka marrë një tabelë krahasuese, sepse ka kërkuar që të marrë shpjegim për çdo nen të Marrëveshjes Kolektive nga cili nen i Ligjit për marrëdhënie pune ose nga marrëveshje kolektive të tjera që tashmë janë nënshkruar në shtet. Ajo ka shpjeguar se është kontrolluar tërësisht baza ligjore, sepse askush nuk dëshiron të nënshkruajë diçka që nuk është në pajtim me Ligjin. Më pas teksti është kontrolluar tërësisht nga shërbimi juridik i Agjencisë, është dhënë mendim nga zyra e avokatëve që ka angazhuar Agjencia dhe po ashtu është kontrolluar dhe nga kryetari i AGJOSH, i cili gjithashtu ka edhe shërbim juridik dhe që nuk vihet në situatë të nënshkruaj diçka që është në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me diskutimin për nenin 7, ajo tha se sipas saj nuk është neni më i rëndësishëm dhe në diskutim u krijua përshtypja se puna në distancë sikur nuk është punë. Ajo deklaroi se bëhet fjalë për punë sikur të punësuarit të jenë në zyrë. Por për të vendosur punën në distancë, fillimisht duhet të krijohet një evidencë përkatëse e orarit të punës, ku do të kontrollohet se sa aktivisht është i përfshirë i punësuarit në procesin e punës. Ajo potencoi se nuk bëhet fjalë për privilegj që nuk do të punohet, nuk duhet kuptuar kështu, kjo është punë, por nga shtëpia, pra distancë. U përmend se shoferët dhe higjienistët nuk do të mund të punojnë nga shtëpia sepse natyra e punës së tyre është e tillë, por ajo shpjegoi se kështu ka qenë edhe gjatë pandemisë dhe do të jetë edhe në disa situata të tjera, gjë që nuk ka do të thotë se janë në pozicion të pabarabartë sepse natyra e punës së tyre nuk e lejon këtë. Ajo supozoi se kështu është edhe në kompanitë e IT-së që u përmendën, sepse edhe ato kanë profile të ndryshme të stafit që nuk mund të punojnë online.

Z. Mashoviq tha se dëshiron të shprehë mbështetjen e saj të plotë për Marrëveshjen Kolektive. Ajo beson se të punësuarit e Agjencisë, të cilët i njej prej kohësh, rreth 14 vite e disa muaj, meritojnë një marrëveshje të tillë. Ajo shprehu respekt ndaj Kryetarit të Këshillit, ndaj anëtarëve të Këshillit për bashkëpunimin afatgjatë dhe ndaj Drejtorit të Agjencisë për lëvizjen që bërë në interes të të punësuarve të cilët realisht meritojnë më shumë se sa është propozuar.

Z. Jançeski theksoi se Propozim-marrëveshja kolektive gëzon shumicën e votave nga Këshilli i Agjencisë. Lidhur me diskutimin për punën e disa kategorive të të punësuarve, ai tha se pas kësaj Marrëveshjeje Kolektive nuk qëndron ndonjë analizë e detajuar në të cilën ka mekanizma kontrolli për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme që të mos ndodhë në të ardhmen që ditët kur punohet online nga shtëpia të mos përputhen me festa, fundjava apo të ngjashme. Pas këtij dokumenti duhet të qëndrojë ndonjë analizë e mirë e institucionit. Agjencia është institucion serioz dhe është e nevojshme vëmendje e veçantë ndaj këtyre çështjeve. Ai theksoi se me ndryshime dhe korrigjime të vogla, ky Propozim-marrëveshje kolektive do të ishte i pranueshëm dhe do ta votonte.

Z. Fidanoski tha se ka përshtypjen se diskutimi nga pak ka nuanca të vendosjes në pozicion të inkuizicionit Spanjoll dhe nuk duhet të jetë kështu. Këshilli është këtu për të bërë atë që i cakton ligji, dhe natyrisht ata vendosin me vullnetin e tyre dhe kjo është një e drejtë e pacënueshme që absolutisht e kanë të gjithë. Mirëpo, siç tha ai, nëse bëhet fjalë për parimet kushtetuese që u përmendën, konsideron se kushte më të favorshme për punë janë përfshirë gjithashtu në disa nga të drejtat themelore të të gjithë qytetarëve, e në këtë rast të të punësuarve në Agjencion. Ai tha se është nxitur nga diskutimi në lidhje me nenin 7 të Propozim-marrëveshjes kolektive. Ai shpjegoi se edhe sot ka jo vetëm kompani informative

por edhe media që punojnë nga shtëpia, më saktë nga distanca. Pas pandemisë, do të thotë 3-4 vite rresht në vazhdimësi, ata punojnë në distancë sepse kështu është dakord shumica ose kështu ka vendosur pronari i medias. Në shoqëritë demokratike perëndimore shumë të zhvilluara, tashmë është bërë praktikë 2 ditë në javë të punohet nga distanca, dhe në këtë mënyrë ulen dhe shpenzimet e punës. Për shembull, siç përmendi drejtori Trajçevski, temperatura jashtëzakonisht të ulëta apo të larta, sëmundje infektive apo ajri i ndotur, situatë në të cilën për 3-5 ditë rresht ose 7 ditë rresht e gjithë Agjencia, me përjashtim të disa të punësuarve, prania e të cilëve është e nevojshme, nuk do të jenë në ambientet e Agjencisë. Ai tha se nuk dëshiron të keqkuptohet, është përkrahës që të punohet nga selia e Agjencisë, por është përkrahës mbi të gjitha për të punuar në mënyrën më optimale dhe efikase për Agjencinë dhe në ato 5, 6 apo 7 ditë të ulen shpenzimet në masën e mjaftueshme me atë që është punuar në distancë, dhe efekti i asaj që është punuar praktikisht të mbetet i njëjtë sikur të ishin këtu në zyra. Për këto arsye, ai mendon se absolutisht duhet të ekzistojë mundësia, siç është thënë nga Organizata sindikale, me organizim nga udhëheqësi ndërmjetësues. Kush, kur, si mund të mos jetë e detyrueshme të punosh në distancë, dhe të arrish të njëjtin efekt njëjtë sikur të ishe në ambientet e Agjencisë, gjatë orarit të punës prej 8 orësh në ditë.

Z. Trajçev tha se nga diskutimet e bëra mendon se duhet të sqarojë diçka. Ai përsëriti se të punësuarit meritojnë më shumë dhe se në këtë Marrëveshje Kolektive ka punë që duhet të mbështeten. Ai tha se nëse do të ishte në vendin e të punësuarve, ndoshta do të thoshte të njëjtën gjë, por nëse ata do të ishin në vendin e tij, do të thoshin atë që sheh ai. Ata këtu veprojnë në cilësinë e anëtarëve të Këshillit ku duhet të miratojnë diçka dhe si avokat shikon punë që mund të çojnë në paqartësi, në kontest gjyqësor në të ardhmen ndërmjet Agjencisë dhe të punësuarve, sepse disa formulime nuk janë parashikuar në mënyrë adekuate. Nuk është kundër të punohet nga shtëpia, dhe ata si anëtarë të Këshillit kanë punuar online, edhe pesë ditë nëse e lejon puna të punojnë nga shtëpia, ato janë punë efikase, por ka vende pune që nuk e lejojnë këtë. Të punosh nga shtëpia nuk është privilegj. Ai tha se do të kthehet përsëri te neni 7, por ka edhe shumë nene të tjera që mund të diskutohen. Për shembull, udhëheqësi mund që gjithë javën të punësuarin ta lejon të punon nga shtëpia, sepse ka kriteret e matshme për ta përcaktuar këtë. Por disa vende punë nuk e lejojnë këtë. Në Propozim-marrëveshje kolektive për çdo të punësuar është një herë në javë. Ai deklaroi se në parim nuk mund ta miraton këtë. Ka edhe dispozita të tjera, si në dispozitat kalimtare ku thuhet se pas dy vitesh, nëse nuk vazhdohet kjo Marrëveshje, mbetet në fuqi përgjithmonë. Sipas tij, ky vendim që duhet ta marrin tani mund të ketë pasoja të rënda për Agjencinë në planin afatgjatë, nesër në marrëdhëniet me Sindikatin. Në çdo rast, të drejtat që jepen në marrëveshje duhet të jepen, por për mënyrën se si janë dhënë, ai nuk do ta mbështesë në parim. Ai ka thënë se nëse të punësuarit të jenë në vendin e tij nga prizëmi ligjor, do ta shihnin kështu. Ai tha se nuk duhet të ketë konfuzion, diskutimi nuk duhet të bëhet në këtë mënyrë, por Propozim-marrëveshja kolektive kështu siç është propozuar, në formën që tashmë është kompletuar dhe negociuar, nuk do ta mbështesë.

Z. Petrushevski tha se do të ishte mirë që vendimi që do të marrin të jetë me shumicë votash. Natyrisht, jo të gjithë anëtarët e Këshillit duhet të bien dakord për gjithçka. Vërejtjet e z. Trajçev janë më të gjera dhe nuk mund të tregojnë sot, të propozon se çfarë duhet ndryshuar. Vërejtjet e z. Jançeski janë po aq serioze, ai nuk e di nëse tani në seancë mund të propozojë diçka apo i duhet pak kohë. Në këtë drejtim ai kërkoi që të deklarohen.

Z. Trajçev tha se tashmë është negociuar me Sindikatën dhe tani nuk mund të ndryshojnë diçka që Sindikata nuk do ta pranojë. Kjo është arsyeja pse ato duhet të ishin përfshirë paraprakisht.

Z. Trajçevski tha se para se Këshilli të votojë dëshiron të njoftojë se do të ketë ndryshim në pjesën e dispozitave kalimtare dhe përfundimtare ku shkruhet "Kjo marrëveshje kolektive hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj". Ai shpjegoi se duhet shtuar se do të aplikohet nga 1 dhjetori në pjesën e pagave sepse pagat e të punësuarve duhet së pari të harmonizohen me Rregulloren e Pagave.

Z. Petrushevski vuri në votim Propozim-marrëveshjen kolektive me korrigjim të datës në pjesën e pagave që do të aplikohet nga 1 dhjetori 2024.

Këshilli i Agjencisë me 4 vota "pro" dhe dy vota kundër nga z. Trajçev dhe z. Jançeski dha miratimin drejtorit të Agjencisë për nënshkrimin e marrëveshjes kolektive të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me çka në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të përcaktohet se dispozitat për pagën, shtesat e pagave dhe të ardhurat e tjera do të zbatohen nga 1 dhjetori.

Organizata sindikale e Agjencisë të bëjë ndryshimet në vijim: Në kreun IV, në nenin 20, paragrafi (17) fshihet, në kreun VI, në nenin 44, pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri që thotë: "Neni 20 do të fillojë të zbatohet duke filluar nga pagesa e pagës për muajin dhjetor 2024". Paragrafi (3) bëhet paragrafi (4).

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kolektive nga Drejtori i Agjencisë dhe Kryetari i Organizatës Sindikale të Agjencisë, e njëjta e vërtetuar i dorëzohet Sindikatës së AGJOSH për nënshkrim.

Marrëveshja Kolektive e lartpërmendur t'u dërgohet me e-mail të punësuarve të Agjencisë.

#### **Pika 4**

##### **Të ndryshme**

Z. Fidanoski tha se në parim do të propozojë, si në të kaluarën, për disa pika që nuk janë çështje e njëjtë por janë sensitive për diskutim. Ai nuk e di se edhe sa kohë në këtë përbërje do të punojë Këshilli, por pyeti në të ardhmen nëse është e mundur, nëse e lejon koha, urgjenca apo të ngjashme, lloj dokumentesh të tilla të merren një ose dy ditë më herët, në mënyrë që ata të kenë më shumë kohë për t'i rishikuar në mënyrë të përgjithëshme.

**Agjenci për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**